



VENDIM

Nr.2 Datë 10.01.2011

PËR

MIRATIMIN UDHËZUESIT PËR APLIKIMIN DHE TARIFAT E LIDHJES SË RE APO MODIFIKIMIT TË LIDHJES EKZISTUESE NË RRJETIN ELEKTRIK TË OST SH.A

Në mbështetje të neneve 9, dhe 26 të Ligjit 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike“ i ndryshuar, Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, neni 18, pika 1, gërma “c”, të miratuar me Vendimin Nr. 21, datë 18.03.2009, dhe pikës V.3.3, të Kodit të Rrjetit të Transmetimit të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.123 datë 24.10.2008, pikës 3.8.2 të Licensës për Aktivitetin e Transmetimit, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 35, datë 09.07.2004, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 01.01.2011, kërkesën e OST sh.a për miratimin e “tarifave të lidhjeve të reja” në rrjetin e transmetimit nëpërmjet një drafti të udhëzuesit “Per aplikimin dhe tarifat e lidhjes së re apo modifikimit të lidhjes ekzistuese në rrjetin elektrik të OST”,

Vendosi:

1. Të miratojë udhëzuesin për aplikimin dhe tarifat e lidhjes së re apo modifikimit të lidhjes ekzistuese në rrjetin elektrik të OST sh.a, (bashkëlidhur këtij vendimi)
2. Ngarkohet OST sh.a për zbatimin e Vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s.
3. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë OST sh.a për këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kv vendim botohet në Fletoren Zyrtare